



Tiranë më

Nr.

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS SË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, TË VULËS SË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, VULËS SË KRYETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE TË VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar përcaktimit të nenit 99, të Kodit Zgjedhor, KQZ dërgon në Komisionet e Administrimit Zgjedhor (KZAZ), materiale zgjedhore që përdoren nga Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë, përfshihen vula e KZAZ-së, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, vula rezervë për KQV-të.

Kodi Zgjedhor, në nenin 103, pika 2, përcakton tekstin që duhet të përmbajë:

Vula e KZAZ-së: KZAZ – Nr.____: që përcakton numrin e KZAZ-së;

Vula e KQV-së: “Komisioni i Qendrës së Votimit” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit gjashtëshifror;

Vula e kryetarit të KQV-së: “KRYETARI” dhe një numër serial gjashtëshifror;

Vula rezervë: teksti “R” është unik për secilën vulë, përcaktuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”.

Në zbatim të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 99, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor, është hartuar projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 Maj 2025.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së, vulës së KQV-së, vulës së Kryetarit të KQV-së dhe vulat rezervë për KQV, referojnë përcaktimet e VKM nr. 390, datë 06.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare, pranë Ministri së Brendshme, me kosto 1800 (njëmijë e tetëqind) lekë.

Ky projektvendim nuk paraqet kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit dhe shpenzimet do të përballohen nga buxheti i miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara Kodi Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, të KQV-së, vulës së kryetarit të KQV-së, vulës rezervë të KQV për zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur projektvendimit paraqiten:

- lidhja 1, formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së;
- lidhja 2, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;
- lidhja 3, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;
- lidhja 4, formati dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së;

Daniela ALIMEMETI

- Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Pavlina DOÇAJ

- Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

VENDIM
PËR

MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS SË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, VULËS SË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, VULËS SË KRYETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe nenit 99, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

- Miratimin e formateve dhe specifikimeve të vulave që do të përdor administrata zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025, si më poshtë:
 - vula e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - vula e Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - vula e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - vula rezervë për Komisionet e Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

